



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT EUGLENT OSMANAJ



Tiranë, më 05.07.2022

Nr. 673/3 Dosje

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT-TIRANE. ✓

Per dijeni:

Debitorit: Shoqeria "NETSYSCOM" sh.p.k, me Perf. Z. Dedë Bukaqeja

Adresa: Shetitorja "Gjergj Fishta", prane Hotel "LISS", Lezhe.

Kreditorit: Shoqeria "Botime Pegi" sh.p.k

Unë, Euglent OSMANAJ , me detyrën e Përmbartuesit Gjyqësor Privat , në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.165, të lëshuar me Datë 06.05.2022 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lezhe kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbartimore Nr. 673, Datë 21.06.2022 kërkesën e kreditorit **Shoqeria "Reg" sh.p.k** ndaj debitorit **Shoqeria "NETSYSCOM" sh.p.k**, në lidhje me titullin ekzekutiv "Fature Tatimore me Nr.2473, date 15.06.2021 , Nr. Serie 100101823".

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.673 Dosje, Datë 22.06.2022 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr.165, date 06.05.2022 në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Adresa: Blv: Gjergj Fishta, Nd.3, Hyrja 6, Ap.8 , Njesia 10 , Tirane.
Email: euglentosmanaj@yahoo.com
Cel: 069 74 90 508

Debitori **Shoqeria "NETSYSCOM" sh.p.k** ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi për të shlyer teresisht detyrimin.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit **Shoqeria "NETSYSCOM" sh.p.k, me Nipt K68426503V** në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.


Në këto kushte, referuar nenit 519, 527 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe të Ligjit Nr. 26, datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ

1. **Venien e mases se sekuestros konservative mbi aktivet e debitorit Shoqeria "NETSYSCOM" sh.p.k, me Nipt K68426503V , deri ne nje urdher te dyte te permbaruesit gjyqësor.**
2. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm në emër të debitorëve të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive.
4. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

PËRMBARUES GJYQËSOR

Euglent OSMANAJ



Adresa: Blv: Gjergj Fishta, Nd.3, Hyrja 6, Ap.8, Njesia 10, Tirane.
Email: euglentosmanaj@yahoo.com
Cel: 069 74 90 508